



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE
SENATI AKADEMIK

Nr. 1009/2 Prot.

Vlorë, më 02.07.2020

VENDIM

Nr. 76, datë 02.07.2020

PËR

**MIRATIMIN E RREGULLORES SË PROGRAMIT TË STUDIMIT TË CIKLIT TË DYTË
"MASTER I SHKENCAVE NË PËRKTHIM DHE INTERPRETIM"**

Mbështetur në shkronjën **d** të pikës **1** në nenin **38** në ligjin Nr. 80/2015 "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë", shkronjën **dh** të pikës **1** në nenin **19** në Statutin e UV-së, Senati Akademik në mbledhjen e datës 02.07.2020

VENDOSI:

1. Të miratojë rregulloren e programit të studimit të ciklit të dytë "Master i shkencave në përkthim dhe interpretim" (bashkëlidhur).

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I SENATIT AKADEMIK

Prof. Dr. Roland ZISI





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI 'ISMAIL QEMALI' VLORË
FAKULTETI I SHKENCËVE HUMANE
DEPARTAMENTI I GJUHËVE TË HUAJA

- f) aftësi për të ndërvepruar dhe ndërtuar marrëdhënie komunikimi dhe pune në një mjedis ndërkulturore në institucione që bashkëpunojnë dhe ndërveprojnë me partnerë dhe bashkëpunëtorë që u përkasin kulturave të ndryshme;
- g) njohuri rreth parimeve të etikës në përkthim dhe interpretim;
- h) aftësi për të kryer shërbime përkthimore në dy gjuhë të huaja, anglisht dhe italisht, veçanërisht në përkthime në gjuhë për qëllime të posaçme (drejtësi, komunikim dhe administrim publik, biznes, letërsi);
- i) aftësi për të kryer kërkim të thelluar e të zbatuar në studime të përkthim-interpretimit;
- j) aftësi për të kryer shërbime redaktoriale pranë institucioneve shtetërore dhe private në përpilimin dhe redaktimin e dokumenteve të hartuara në gjuhë të huaj.

Neni 3

Disiplinat dhe veprimtaritë formuese të programit sipas krediteve

1. Kurrikula e programit të studimit “Master i shkencave në përkthim dhe interpretim” organizohet në:
 - a. Lëndë bazë;
 - b. Lëndë karakterizuese;
 - c. Lëndë ndërdisiplinore/ integruese;
 - d. Lëndë plotësuese;
 - e. Detyrime përmbyllëse.
2. Kurset/lëndët në program dallohen nga emërtimi, kodi dhe numri i krediteve. Kodi përcakton këta elemente: gjuhën në të cilën zhvillohet kursi ose fushën e studimit të cilës i përket dhe vitin e studimit në të cilin ofrohet. Kështu, kurset/lëndët me kode “MTI ...” tregojnë fushën specifike të programit (akronim i “Master in Translation and Interpretation”), me kode “ENG ...” zhvillohen në gjuhën angleze, me “ITA ...” në gjuhën italiane, me “ALB ...” në gjuhën shqipe, me “CS...” ofrohen nga Departamenti i Informatikës.
3. Përmbyllja tematike e kurseve, të dhënat mbi kursin, mënyrën e vlerësimit, kontrollit të dijes, literatura e detyruar etj. paraqiten në *syllabus*-et përkatëse të çdo lënde dhe shpallen në fillim të semestrit nga pedagogu përkatës.
4. Më poshtë paraqitet lista e disiplinave dhe veprimtaritë formuese të programit të shprehura të ndara në kredite për disiplinë dhe tipin e komponentit mësimor si vijon:

Kategori a	Tipi i mësimor	komponentit	Lëndët që bëjnë pjesë këtu
A	LËNDË përgatitje	BAZË –	MTI 510 Teori dhe teknika të përkthimit dhe interpretimit, 6 kredite



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI 'ISMAIL QEMALI' VLORË
FAKULTETI I SHKENCAVE HUMANE
DEPARTAMENTI I GJUHËVE TË HUAJA

RREGULLORE E PROGRAMIT TË STUDIMIT
“MASTER I SHKENCAVE NË PËKTHIM DHE INTERPRETIM”

Kjo rregullore është hartuar mbështetur dhe në zbatim të ligjit nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, si dhe në udhëzimin nr. 41, datë 24.1.2018 “Për elementet e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë”, Statutin dhe Rregulloren e Universitetit “Ismael Qemali”, Vlorë.

Neni 1


Emërtimi dhe statusi i programit

1. Programi i studimit “Master i shkencave në përkthim dhe interpretim” ofrohet nga Departamenti i Gjuhëve të Huaja, Fakulteti i Shkencave Humane, në koordinim të veprimtarive formuese, edhe me njësitë e tjera të këtij fakulteti dhe të Fakultetit të Shkencave Teknike. Ky program studimi është program i ciklit të dytë, “Master”, i cili ofrohet në dy vite akademike, në përfundim të të cilit studenti grumbullon 120 kredite (ECTs) dhe merr diplomën universitare: “Master i shkencave në përkthim dhe interpretim”.
2. Përveç njësive bazë dhe kryesore, programi do të realizohet edhe me mbështetjen e institucioneve dhe subjekteve shtetërore dhe private që kanë nevojë për përkthyes dhe interpretë të kualifikuar dhe të pajisur me shprehitë përkatëse.

Neni 2

Objektivat formues të programit

1. Ky program synon përgatitjen e specialistëve të lartë në përkthim dhe interpretim të pajisur me:
 - a) njohuri të thelluara në shkencat filologjike;
 - b) aftësi për të interpretuar dhe përkthyer në dy gjuhë të huaja (anglisht dhe italisht) në mjedis pune, biznesi dhe kontekste të larmishme kulturore dhe ndërkulturore;
 - c) njohuri të thelluara teorike në lidhje me teknikat dhe teoritë e përkthimit dhe interpretimit, si dhe funksionimin e tyre në praktikë në gjuhët e studimit (anglisht dhe italisht);
 - d) njohuri rreth studimeve evropiane dhe politikave evropiane për përkthimin;
 - e) aftësi për të ndërtuar korpusë gjuhësore për analiza të thelluara në fushën e përkthimit;



REPUBLIKA E SHQIPËRIË

UNIVERSITETI 'ISMAIL QEMALI' VLORE
FAKULTETI I SHKENCAVE HUMANE
DEPARTAMENTI I GJUHËVE TË HUAJA

	metodologjike dhe kulturë e përgjithshme 12 kredite	MTI 536 Metoda kërkimore në studime të përkthimit dhe interpretimit, 6 kredite
B	LËNDË KARAKTERIZUESE – përgatitje për disipinën shkencore 66 kredite	ENG 501/ITA 501 Studime evropiane, 6 kredite
		ENG 521/ITA 521 Përkthim nga B në A dhe nga A në B, 8 kredite
		ENG 522/ITA 522 Interpretim Konsekutiv nga B në A dhe nga A në B, 8 kredite
		ENG 523/ITA 523 Interpretim Simultan nga B në A dhe nga A në B, 8 kredite
		ENG 530/ITA 530 Përkthim nga C në A, 6 kredite
		ENG 531/ITA 531 Interpretim nga C në A, 6 kredite
		ALB 520 Gjuhë standarde shqipe, 6 kredite
		MTI 512 Analizë teksti në përkthim, 6 kredite
		<i>Zgjidh një nga:</i> <u>6 kredite</u> ENG 532/ITA 532 Përkthim teknik dhe shkencor nga B në A dhe nga A në B, 6 kredite ENG 533/ITA 533 Përkthim letrar nga B në A dhe nga A në B, 6 kredite ENG 534/ITA 534 Përkthim biznesi dhe ligjor nga B në A dhe nga A në B, 6 kredite ENG 535/ITA 535 Përkthim kompjuterik nga B në A dhe nga A në B, 6 kredite ENG 536/ITA 536 Përkthim mediatik nga B në A dhe nga A në B, 6 kredite
		<i>Zgjidh një nga:</i> <u>6 kredite</u> ENG 537/ITA 537 Përkthim teknik dhe shkencor nga C në A, 6 kredite ENG 538/ITA 538 Përkthim letrar nga C në A, 6 kredite ENG 539/ITA 539 Përkthim biznesi dhe ligjor nga C në A, 6 kredite



REPUBLIKA E SHQIPËRIË

UNIVERSITETI 'ISMAIL QEMALI' VLORE
FAKULTETI I SHKENCAVE HUMANE
DEPARTAMENTI I GJUHËVE TË HUAJA

		ENG 541/ITA 541 Përkthim kompjuterik nga C në A, 6 kredite ENG 542/ITA 542 Përkthim mediatik nga C në A, 6 kredite
C	LËNDË NDËRDISIPLINORE/INT E GRUESE – nëndisiplina, profile dhe grup-lëndë me zgjedhje 12 kredite	<u>Zgjidh një nga: 6 kredite</u> MTI 513 Parime të redaktimit dhe matjes së cilësisë në përkthim, 6 kredite MTI 514 Parime të cilësisë dhe etikës profesionale në interpretim, 6 kredite <u>Zgjidh një nga: 6 kredite</u> MTI 515 Studime të përkthim-interpretimit dhe komunikimi ndërkulturor, 6 kredite MTI 516 Studime të përkthim-interpretimit dhe institucionet ndërkombëtare, 6 kredite
D	LËNDË PLOTËSUESE – gjuhë të huaja, njohuri informatike, praktika profesionale 12 kredite	CSE 540 Teknologjia në përkthim, 6 kredite MTI 543 Praktikë profesionale, 6 kredite
E	DETYRIME PËRMBYLLËSE 18 kredite	MTI 544 Teza e diplomës

Shënim: Lënda konsiderohet e shlyer nëse të gjitha modulet kanë nota kaluese.

Neni 4
Plani mësimor

1. Më poshtë paraqitet plani mësimor i studimit, i detajuar me semestra, me disiplinat dhe veprimtaritë formuese përkatëse të programit të shprehura të ndara në kredite, orë mësimore në auditor dhe jashtë auditorit për disiplinë si vijon:

Plani mësimor “Master i shkencave në përkthim dhe interpretim”

Viti	Semes		Kredit	Totali orë/se mestër	Totali orë/se mestër	Totali orë brenda auditorit	Totali orë jashtë auditorit
------	-------	--	--------	----------------------	----------------------	-----------------------------	-----------------------------



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI 'ISMAIL QEMALI' VLORE
FAKULTETI I SHKENCAVE HUMANE
DEPARTAMENTI I GJUHËVE TË HUAJA

		Kodi	Lënda		brenda dhe jashtë auditor it	në audito r	Lek	Sem	Lab	Detyra
Viti I	Sem. I	MTI 510	Teori dhe teknika të përkthimit dhe interpretimit	6	150	60	2	2		90
		ALB 520	Gjuhë standarde shqipe	6	150	60	2	2		90
		CSE 540	Teknologjia në përkthim	6	150	60	2	2		90
		ENG 532/ITA 532 ENG 533/ITA 533 ENG 534/ITA 534 ENG 535/ITA 535 ENG 536/ITA 536	<i>Zgjidh një nga:</i> Përkthim teknik dhe shkencor nga B në A dhe nga A në B Përkthim dhe redaktim letrar nga B në A dhe nga A në B Përkthim biznesi dhe ligjor nga B në A dhe nga A në B Përkthim kompjuterik nga B në A dhe nga A në B Përkthim mediatik nga B në A dhe nga A në B	6	150	60	2	2		90
		ENG 537/ITA 537 ENG 538/ITA 538 ENG 539/ITA 539 ENG 541/ITA 541 ENG 542/ITA 542	<i>Zgjidh një nga:</i> Përkthim teknik dhe shkencor nga C në A Përkthim dhe redaktim letrar nga C në A Përkthim biznesi dhe ligjor nga C në A Përkthim kompjuterik nga C në A Përkthim mediatik nga C në A	6	150	60	2	2		90
	TOTALI			30	750	300	10	10		450
	Sm. II	ENG 522/ITA 522	Interpretim Konsekutiv nga B në A dhe nga A në B	8	200	75	1		4	125
		ENG 523/ITA 523	Interpretim Simultan nga B në A dhe nga A në B	8	200	75	1		4	125
		ENG 521/ITA 521	Përkthim nga B në A dhe nga A në B	8	200	90	2	2	2	110
		ENG 530/ITA 530	Përkthim nga C në A	6	150	60	2	2		90
TOTALI			30	750	300	6	4	10	450	
Second Year	Sem. III	MTI 514 MTI 513	<i>Zgjidh një nga:</i> Parime të cilësisë dhe etikës profesionale në interpretim Parime të redaktimit dhe matjes së cilësisë në përkthim	6	150	60	2	2		90
		MTI 512	Analizë teksti në përkthim	6	150	60	2	2		90
		MTI 515 MTI 516	<i>Zgjidh një nga:</i> Studime të përkthim-interpretimit dhe komunikimi ndërkulturor Studime të përkthim-	6	150	60	2	2		90



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI 'ISMAIL QEMALI' VLORE
FAKULTETI I SHKENCAVE HUMANE
DEPARTAMENTI I GJUHËVE TË HUAJA

		interpretimit dhe institucionet ndërkombëtare							
	MTI 536	Metoda kërkimore në studime të përkthimit dhe interpretimit	6	150	60	2	2		90
	ENG 501/ITA 501	Studime evropiane	6	150	60	2	2		90
	TOTALI		30	750	300	10	10		450
Sem. IV	MTI 543	Praktikë profesionale	6	150	0	0	0		150
	ENG 531/ITA 531	Interpretim nga C në A	6	150	60	2	2		90
	MTI 544	Teza e diplomës	18	450	0	0	0		450
	TOTALI		30	750	60	2	2		690

Neni 5

Gjuha e studimit të programit

1. Lëndët në këtë program studimi ofrohen në gjuhët shqip, anglisht dhe italisht. Lëndët e specifikave të përkthimit do të zhvillohen kryesisht në gjuhët anglisht dhe italisht.
2. Simbolet A, B, dhe C të përdorura në planin mësimor për të emërtuar lloje të ndryshme përkthimi qëndrojnë për gjuhët që përdoren në program, ku A është gjuha amtare dhe B dhe C janë gjuha e parë e huaj dhe gjuha e dytë e huaj.
3. Çdo student që i nënshtrohet këtij programi studimi duhet të aftësohet të përkthejë në dy gjuhë të huaja. Gjuhët e huaja të ofruara në këtë program studimi janë anglisht dhe italisht.
4. Për studentin që zotëron një diplomë “Bachelor në gjuhë angleze”, kombinimi i gjuhëve do të jetë: A = gjuhë shqipe (amtare), B = gjuhë angleze dhe C = gjuhë italiane.
5. Për studentin që zotëron një diplomë “Bachelor në gjuhë italiane”, kombinimi i gjuhëve do të jetë: A = gjuhë shqipe (amtare), B = gjuhë italiane dhe C = gjuhë angleze.
6. Për studentin që zotëron një diplomë “Bachelor” në çdo gjuhë tjetër, kombinimi i gjuhëve do të jetë një nga kombinimet e mësipërme sipas parapëlqimit të studentit.

Neni 6

Njohuritë dhe kompetencat e studentëve në përfundim të programit mësimor

1. Në përfundim të programit të studimit, pritet që studenti të ketë përvetësuar këto kompetenca dhe rezultate të të nxënit që u korrespondojnë sipas tabelës më poshtë:

A.	Kompetenca bazë	Rezultatet e të nxënit të programit
I	Kompetenca të aftësimit vetjak dhe të organizimit të pavarur	1.1. Aftësi për të organizuar aktivitete studimore dhe profesionale në mënyrë të pavarur, për të zbatuar shprehje praktike dhe hulumtuese.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI 'ISMAIL QEMALI' VLORË
FAKULTETI I SHKENCAVE HUMANE
DEPARTAMENTI I GJUHËVE TË HUAJA

2	Kompetenca shoqërore dhe komunikuese	2.1	Aftësi për të kuptuar ndikimin që dallimet kulturore kanë në ndërveprimet shoqërore dhe për të komunikuar, ndërvepruar dhe bashkëpunuar me sukses në një mjedis shumëkulturore.
3	Kompetenca të organizimit dhe seleksionimit të informacionit	3.1.	Aftësi për të punuar me burime të ndryshme informacioni, për të vlerësuar dhe përzgjedhur në mënyrë kritike, si dhe për të përdorur në mënyrë praktike informacionin që lidhet me profesionin e ardhshëm, por jo vetëm.
B. Kompetenca gjuhësore		Rezultatet e të nxënës të programit	
4	Kompetenca të përgjithshme gjuhësore	4.1.	Njohuri bazë të gjuhëve të studimit të programit që lidhen me elementet strukturore të gjuhës, funksionet e tyre, përdorimet gjuhësore, aktet e komunikimit.
		4.2.	Aftësi për të përdorur gjuhën e huaj për qëllime të përgjithshme në përkthim në një kontekst ndërkulturore.
		4.3.	Aftësi për të mbledhur të dhëna gjuhësore me qëllim kryerjen e studimeve dhe analizave duke zbatuar metoda të ndryshme kërkimore.
5	Kompetenca socio-gjuhësore	5.1	Aftësi për të diskutuar me folës të gjuhëve të tjera dhe që u përkasin kulturave të tjera në mënyrë të përshtatshme dhe pa gabime në formulimin e ideve.
		5.2.	Aftësi për të komunikuar në mënyrë të përshtatshme duke zgjedhur fjalët, shprehjet dhe qëndrimin ndaj një rrethane, mjedis, temë apo marrëdhënie e caktuar.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI 'ISMAIL QEMALI' VLORË
FAKULTETI I SHKENCAVE HUMANE
DEPARTAMENTI I GJUHËVE TË HUAJA

C. Kompetenca të fushës/profesionale		Rezultatet e të nxënit të programit	
6	Kompetenca kulturore dhe ndërkulturore	6.1.	Njohuri rreth kulturës, politikës dhe studimeve evropiane.
		6.2.	Njohje e koncepteve si multilinguizëm, plurilinguizëm, Evropë shumëgjuhëshe.
		6.3.	Aftësi për të kuptuar dukuri kulturore dhe ndërvepruar në situata të caktuara kulturore dhe ndërkulturore përmes kompetencës ndërkulturore në situata përkthimi dhe interpretimit.
		6.4.	Aftësi për të mbledhur dhe analizuar të dhëna kulturore për të kryer studime përfaqësuese dhe analiza të dukurive të ndryshme në kontekstin e përkthimit dhe interpretimit.
		6.5.	Aftësi për të përdorur të gjitha këto kompetenca dhe koncepte kulturore, ndërkulturore dhe evropiane në komunikim dhe ndërveprim me të huaj për qëllime pune.
7	Kompetenca përkthimore, interpretuese dhe redaktoriale	7.1.	Njohuri rreth parimeve të teorive të përkthimit, interpretimit dhe redaktimit, të zbatimit të tyre në praktikë, të proceseve dhe produkteve përkthimore/redaktoriale, metodave dhe strategjive, të veçantat e stileve të ndryshme të përkthimit/redaktimit, si dhe mjeteve të ndryshme të përkthimit/redaktimit.
		7.2.	Aftësi për të zbatuar njohuri teorike rreth metodave të përkthimit, interpretimit dhe redaktimit gjatë aktiviteteve të ndryshme përkthimore, interpretuese dhe redaktoriale.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI 'ISMAIL QEMALI' VLORE
FAKULTETI I SHKENCAVE HUMANE
DEPARTAMENTI I GJUHËVE TË HUAJA

		7.3.	Aftësi për të përkthyer e redaktuar saktë dhe në mënyrë koherente dhe kohezive tekste të ndryshme nga shkencat humane dhe sociale, biznesi, drejtësia e letërsia, në mënyrë që përmbajtja e stili të përcillen sa më qartë e në përputhje me qëllimin dhe kontekstin socio-kulturor të tekstit.
		7.4.	Aftësi për të përkthyer në gjuhë për qëllime të posaçme në komunikimin me shkrim dhe me gojë në një kontekst ndërkulturor.
		7.5.	Aftësi për të përdorur databaza, terminologji bankare, korpuse gjuhësore, software të përkthimit dhe mjete të tjera digjitale për përkthimin dhe redaktimin.
8	Kompetenca hulumtuese dhe shkencore	8.1.	Aftësi për të kryer kërkim për çështje të përkthim-interpretimit duke zbatuar metoda të kërkimit, filologjike dhe ndërdisiplinore.
		8.2.	Aftësi për të kryer analiza teksti duke vlerësuar modelet e përkthimit/redaktimit, metodat, strategjitë, stilet, si dhe avantazhet dhe disavantazhet e tyre.
		8.3.	Aftësi për të ndërtuar korpuse gjuhësore, software etj për të kryer analiza sasiore.
		8.4.	Aftësi për të realizuar projekte kërkimore për dukuri gjuhësore, kulturore e letrare në fushën e përkthim-interpretimit.
9	Kompetenca të etikës në profesion	9.1	Njohuri rreth çështjeve si etikës në profesionin e përkthyesit, interpretit.
10	Kompetenca teknologjike	10.1.	Aftësi për të përdorur teknologjinë, sidomos atë të informacionit për shërbime përkthimore.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI 'ISMAIL QEMALI' VLORË
FAKULTETI I SHKENCAVE HUMANE
DEPARTAMENTI I GJUHËVE TË HUAJA

Neni 7

Format dhe organizimi i studimit të programit

1. Veprimtaritë formuese që karakterizojnë programin e studimit “Master i shkencave në përkthim dhe interpretim” ndahen në: mësim në auditor (leksione, seminare,) studim individual (studim, punim relacionesh, detyrash apo projektesh, përgatitje provimesh, përgatitje e tezës së diplomës etj).

Neni 8

Format e kontrollit të dijes

1. Programi mësimor “Master i shkencave në përkthim dhe interpretim” parashikon vlerësime vjetore, provime përfundimtare të lëndëve mësimore dhe punim të temës së diplomës.
2. Për modulet e koordinuara (që përmbajnë më shumë se një lëndë) bëhet vlerësimi kolegjal i studentit në bazë të përqindjes së pikëve që ai ka grumbulluar në vlerësimet e secilës prej lëndëve përbërëse të modulit. Format e kontrollit të dijeve përfshijnë detyrat e kursit, projektet, esetë, provimet e kursit, temat e diplomave.
3. Kreditet korresponduese për çdo veprimtari formuese fitohen nga studentët vetëm për vlerësim pozitiv në verifikimin përfundimtar të dijeve të fituara prej tyre. Për verifikimin e dijeve përdoren forma të ndryshme që kombinojnë verifikimin e vazhdueshëm (provimet e pjesshme, projektet/detyrat e kursit) me atë përfundimtar (provimin final).
4. Kontrolli i dijes së një lënde (provimi) përcaktohet nga titullari i lëndës dhe mund të bëhet:
 - a) me shkrim,
 - b) me gojë,
 - c) i kombinuar, me shkrim e me gojë, duke u mbështetur në programin mësimor.
5. Vlerësimi përfundimtar i modulit bëhet ose vetëm përmes një provimi përfundimtar, ose përmes një provimi të pjesshëm, një provimi përfundimtar dhe/ose kërkesat specifike që vendos çdo pedagog për lëndën në syllabus.
6. Tezat e provimit, në të gjitha rastet e kontrollit, hartohen dhe firmosen nga titullari i lëndës. Kompromentimi i tezës është përgjegjësi direkte e pedagogut.

Neni 9

Kushtet për t’u konsideruar kalues në një lëndë

1. Shkalla e përvetësimit të programit mësimor vlerësohet me sistemin prej dhjetë notash, 1, ... , 10. Notat nga pesë e lart janë kaluese.
2. Në format e kontrollit me shkrim (provime, detyra/projekte kursi) përdoret sistemi i vlerësimit me pikë, rezultati i të cilit, detyrimisht, konvertohet në notë. Në vlerësimin final të



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI 'ISMAIL QEMALI' VLORE
FAKULTETI I SHKENCAVE HUMANE
DEPARTAMENTI I GJUHËVE TË HUAJA

lëndës, pedagogu përkatës përcakton edhe peshën e vlerësimit të punës së pavarur të studentit (detyrave/projekteve të kursit).

3. Normat e konvertimit në notë të pikëve të grumbulluara përcaktohen nga pedagogët përkatës në çdo *syllabus*, por minimumi i përqindjes së pikëve të grumbulluara për marrjen e një vlerësimi pozitiv (me notë 5) është $\geq 40\%$ në të gjitha modulet. Ulja e këtij kufiri mund të bëhet pas daljes së rezultateve të të gjithë grupit, me propozim të pedagogut të lëndës dhe miratim të përgjegjësit të departamentit, kur kjo është e justifikuar dhe e argumentuar.

4. Për modulet e integruara (që përmbajnë më shumë se një lëndë) bëhet vlerësimi kolegjial i studentit në bazë të shumës së përqindjes së pikëve që ai ka grumbulluar në vlerësimet e secilës prej lëndëve përbërëse të modulit. Për të marrë një vlerësim pozitiv përfundimtar, studentit duhet të ketë grumbulluar $\geq 40\%$ jo vetëm të totalit të modulit, por edhe të pikëve përkatëse të çdo lënde përbërëse të modulit të integruar.

Neni 10


Procedurat e testimit dhe apelimit të rezultateve të testimit nga ana e studentëve

1. Procedura e kontrollit të dijeve është si më poshtë:
 - a) Kontrolli i njohurive bëhet thjesht me një provim final, ose me një provim të pjesshëm dhe një provim final, si dhe me anë të detyrave të kursit.
 - b) Pas 48 orësh brenda kryerjes së kontrollit të njohurive (me gojë ose me shkrim) pedagogu njofton studentët për rezultatin e vlerësimit në provim. Ky afat mund të tejkalohet deri në 72 orë në rastet kur pedagogu i lëndës ka zhvilluar më shumë se një provim në një ditë.
2. Studenti ka të drejtë të shikojë fletën e tij të provimit individualisht.
3. N.q.s është i paqartë ose nuk është dakord me vlerësimin që ka marrë, ka të drejtë të kërkojë sqarime nga pedagogu përkatës.
4. N.q.s studentit është i paqartë ose nuk bindet për rezultatin e provimit, paraqet një kërkesë me shkrim pranë sekretarisë së departamentit.
5. Në bazë të kësaj kërkesë departamenti ngre një komision apelimi *ad hoc* për vlerësimin e kërkesës së studentit. Komisioni duhet të bëjë rivlerësimin e provimit të studentit dhe duhet të japë përgjigje brenda tri ditëve nga çasti i paraqitjes së kërkesës për rivlerësim.
6. Pikët përfundimtare të testimit janë ato të vendosura nga komisioni i apelimit.

Neni 11

Orari i studimit dhe provimeve

1. Koha dhe auditori i zhvillimit të mësimit përcaktohet në orarin e shpallur nga Departamenti i Gjuhëve të Huaja. Orari duhet të respektohet plotësisht nga të gjithë studentët dhe mësime të tjerë.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI 'ISMAIL QEMALI' VLORE
FAKULTETI I SHKENCAVE HUMANE
DEPARTAMENTI I GJUHËVE TË HUAJA

2. Orari i përgjithshëm i universitetit duhet të shpallet të paktën 3 javë përpara fillimit të semestrit. Orari i provimeve finale duhet të shpallet jo më vonë se 3 javë nga mbarimi i semestrit.
3. Orari duhet të përmbajë: kodin dhe emërtimin e lëndës, orarin, sallën ku do të kryhet mësimi/provimi dhe emrin e pedagogut përkatës.

Neni 12

Detyrimet e mundshme që lidhen me frekuentimin

1. Frekuentimi i leksioneve është i detyrueshëm në masën 75%.
2. Frekuentimi i seminareve është i detyrueshëm në masën 75%.

Neni 13

Karakteristikat e detyrave/projekteve të kursit

1. Detyrat dhe projektet e kursit mund të jenë disa lloje: ese ose kërkim në fushën përkatëse, projekt kërkimor, punë prezantuese, poster.
2. Kërkesat për mënyrën e organizimit të detyrës, përmbajtjen, mënyrën e paraqitjes së punimit, përgatitjen teknike të tij/saj përcaktohen nga pedagogu përkatës.

Neni 14

Vlerësimi për diplomim

1. Studentët diplomohen me punim diplome.
2. Punimet e diplomës duhet të përmbushin kërkesat e mëposhtme:
 - a. të jenë studime individuale e origjinale,
 - b. të jenë studime të mirëfillta analitike e shkencore,
 - c. me udhëheqje shkencore,
 - d. të ndjekin rregullat e shpallura nga DGJH për paraqitjen e punimit, bazuar në shtojcat në Vendimin e Senatit Akademik Nr. 65, datë 14.11.2016, si dhe Rregulloren e punimeve të miratuar nga DGJH (bashkëlidhur).
3. Punimi i tezës së diplomës dorëzohet pranë sekretarisë mësimore në tri kopje të shtypura dhe lidhura sipas modelit të paraqitur në rregulloren e punimeve, si dhe në formë elektronike në CD brenda afatit të lajmëruar nga sekretaria. Një kopje dorëzohet në bibliotekën e fakultetit, një kopje ruhet në departament (pranë Këndit të Leximit) dhe një kopje i jepet reçensuesit të punimit, i cili pas përfundimit të procesit të mbrojtjes së tezës së diplomës e kthen atë në departament.
4. Mbrojtja e tezës së diplomës bëhet përpara një komisioni prej 5 (pesë) anëtarësh.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI 'ISMAIL QEMALI' VLORE
FAKULTETI I SHKENCAVE HUMANE
DEPARTAMENTI I GJUHËVE TË HUAJA

5. Studenti diplomant bën një paraqitje përmbledhëse të punimit prej afërsisht 20 minutash. Në përfundim të prezantimit, anëtarët e komisionit i drejtojnë studentit pyetje rreth punimit. Reçensuesi bën vlerësimin e vet të punimit, të cilin e paraqet para komisionit. Në fund, komisioni kryen vlerësimin me notë të studentit, duke u bazuar mbi këto elemente: a) origjinaliteti, cilësia dhe paraqitja e punimit sipas përcaktimeve në rregulloren e punimeve; b) prezantimi i punimit; c) vlerësimi i reçensuesit.

Neni 15

Modalitetet për dhënien e diplomës

1. Në përfundim të kursit të plotë të studimeve, studentët kanë të drejtë të diplomohen. Kërkesat për fitimin e diplomës së ciklit të dytë të studimeve janë:
 - a. Studenti duhet të jetë vlerësuar pozitivisht në të gjitha modulet e detyrueshme në disiplinat:
 - e formimit bazë (2)
 - karakterizues (6)
 - ndërdisiplinore/integruese (4)
 - plotësuese (2)
 - b. Studenti duhet të ketë vlerësim 'kalues' në provimin e formimit/punimin e diplomës.
 - c. Në përfundim të studimeve të ketë grumbulluar të 120 ECTS (kredite).
2. Pasi ka shlyer të gjitha detyrimet akademike dhe financiare, studenti paraqitet pranë sekretarisë mesimore të DGJH-së për të kryer procedurat përkatëse.

Neni 16

Shkeljet e integritetit akademik

1. Të gjithë anëtarët e komunitetit akademik duhet të praktikojnë dhe të ruajnë standardet e integritetit akademik dhe ndershmërisë. Integritet akademik do të thotë të paraqesësh vetveten dhe punën tënde me ndershmëri. Prezantimi i keq i vetvetes dhe punës është mashtrim, sepse do të thotë që studentët pretendojnë kredite për ide apo punë që nuk janë në të vërtetë vepër e tyre dhe në këtë mënyrë kërkojnë një diplomë që në të vërtetë nuk është fituar. Më poshtë janë disa shembuj pandershmërie akademike:
 - a. Mashtrim në provime. Këtu përfshihen të përdorësh materiale si libra dhe/ose shënime atëherë kur një gjë e tillë nuk është e autorizuar nga pedagogu, të kopjosh nga testimi apo detyra e dikujt tjetër, të ndihmosh dikë tjetër të kopjojë punën, të zëvendësosh punën e dikujt tjetër me punën tënde, të vjedhësh kopje të provimeve, ose të tjera forma shkeljesh në sjelljeje gjatë provimeve.
 - b. Plagjiaturë e punës së të tjerëve. Plagjiaturë do të thotë të përdorësh punën ose idetë e dikujt tjetër pa i dhënë atij personi kredit për punën e vet; duke bërë këtë studentët



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI 'ISMAIL QEMALI' VLORË
FAKULTETI I SHKENCAVE HUMANE
DEPARTAMENTI I GJUHËVE TË HUAJA

pretendojnë kredit për mendimin e dikujt tjetër. Studentët duhet të dokumentojnë gjithmonë burimin e informacionit qoftë atëherë kur e kanë lexuar edhe atëherë kur e kanë dëgjuar. Kur punohet me burime të shkruara, një dallim i qartë duhet bërë midis thonjzave (të cilat riprodhojnë informacionin fjalë për fjalë nga burimi dhe e vendosin atë midis thonjzave) dhe perifrazimeve (të cilat e përpunojnë burimin e informacionit dhe e paraqesin atë me fjalët e studentit. Qoftë citimet midis thonjzave, qoftë perifrazimet duhen të dokumentohen në çdo rast. Edhe në rastin kur studentët rishprehin, përmbledhin apo përzgjedhin pjesë nga puna e tjetrit, idetë i përkasin në çdo rast personit tjetër, dhe mosdhënia kredit punës së tij përbën prezantim të keq të punës aktuale të studentit dhe plagjiaturë e ideve të dikujt tjetër. Të blesh një detyrë kursi ose të përdorësh informacion nga Rrjeti Ndërkombëtar i Informacionit ose Interneti pa njohur burimin dhe ta dorëzosh atë si punë vetjake është plagjiaturë.

c. Falsifikimi i dokumentave apo paraqitja dizinformuese e kredencialeve të një personi është shkelje.

d. Bashkëpunimi i paautorizuar në detyra kompjuterike dhe hyrje e paautorizuar dhe përdorimi i programeve kompjuterikë duke përfshirë modifikimin e skedar kompjuterikë të krijuar nga të tjerë dhe të paraqesësh atë punë si punën tënde është shkelje. Me përjashtim të rasteve kur japin udhëzime specifike, në të gjitha rastet pedagogët presin prej studentëve punë individuale pa ndihmën e të tjerëve në detyra kursi, provime, raporte laboratorit dhe ushtrime kompjuterike, si dhe dokumentacion të të gjitha burimeve në rastet kur këto vihen në përdorim. Nëse pedagogët caktojnë një projekt të veçantë përveç ose si shtesë ndaj provimeve, si për shembull detyrë kursi e bazuar në punë kërkimore, apo ese origjinale ose referatë e një libri, ata kanë përcaktuar që kjo punë është përmbushur vetëm për atë kurs. Studentët nuk duhet të dorëzojnë punën e kryer në një kurs që është marrë në të kaluarën apo për një kurs bashkëekzistues, përveç rasteve kur studenti ka leje të qartë për të bërë kështu nga të dy anëtarët e personelit akademik që janë pedagogë të kurseve.

Neni 17
Dispozita të veçanta

